REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:039597

Datë: 17.07.2020

Numri i dokumentit: 01028891

**P.nr. 122/2020**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Besarta Doli dhe me zyrtares ligjore Shkendije Halilosmani, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 paragraf 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( në tekstin e mëtejmë KPRK-së), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 305/2020 të datës 13.03 2020, e parashtruar në gjykatë me datë 03.04.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me **datë 15.07.2020** në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, prokurorit të shtetit Enis Gashi, të dëmtuarës E.G. mbrojtëses së viktimave F.B-Q. si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë murr dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 17.07.2020, përpiloj këtë:

**A K T GJ Y K I M**

I akuzuari **E.R.,** nga Gjakova, i biri i M., dhe i L., e gjinisë B., data e lindjes... .në Gjakovë, ka të kryer shkollën fillore, punëtor në autolarje, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa dënuar, rom, shtetas i Republikës së Kosovës. me numër personal ...

**Ë sh t ë f a j t o r**

Sepse me datë 03.03.2020 rreth orës 09.00/h dhe me parë që nga bashkëjetesa për më së tri vite, në Gjakovë, pikërisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i shkakton keqtrajtim fizik, psiqik ose ekonomike, me qëllim të cenimit te personit tjetër brenda një marrëdhënie familjare, këtu të dëmtuarës E.G – me të cilën bashkëjetojnë, në atë mënyrë që nga dita e bashkëjetesës në vazhdimësi, i akuzuari e ka keqtrajtuar të dëmtuarën në mënyrë sistematike, duke e sulmuar fizikisht, duke ushtruar dhunë fizike, psiqike dhe psikologjike, ashtu ditën kritike, i akuzuari i revoltuar e sulmon fizikisht të dëmtuarin, duke e goditur me grusht në krah, me çka të dëmtuarën i shkakton dhimbje.

- Me çka ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 paragraf 1 të KPRK-së.

Gjykata në kuptim të dispozitës së neneve 2, 3 paragraf 1,nenit 4, 6, 7, 17 nenit 38, nenit 39 paragraf. 1 nën paragraf 1.2, nenit 46 paragraf 1 nën paragraf 1.1 dhe paragraf 2 nën paragraf 2.2 , neneve 47, 48, 49, 50, 55, 69, 70, 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3, nenit 184 paragraf 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, i shqipton

2020:042945

**DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit **E.R., i** shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **90 (nëntëdhjetë) ditëve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda kohës verifikimit në afatin prej **1 (një) viti**, nuk do të kryen vepër tjetër penale, e në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Obligohet i akuzuari që të mbajë kontakt me Shërbimin Sprovues të Kosovës, i cili do të bëjë mbikëqyrjen e periudhës së verifikimit të dënimit me kusht .

E dëmtuara E.G. nga Gjakova, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore – juridike.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën sipas llogaris përfundimtare të kësaj gjykate, në emër paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.-€, si dhe në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 30.-€, e krejt këto në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj Gjykate me datë 03.04.2020, Prokuroria Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë PP/II.nr. 305/2020 të datës 13.03.2020, kundër të akuzuarit E.R. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 paragrafin 1 të KPRK-së lidhur me veprën penale dhuna në familje nga neni 248 paragraf 2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Enis Gashi, në shqyrtimin fillestar duke u bazuar në udhëzimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 11.06.2020, lidhur me cilësimin juridik dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje, ka bërë përmirësimin e kualifikimit juridik, ashtu që duhet të jetë " me këto veprime ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 paragraf 1 të KPRK-së, ndërsa sa i përket nenit 248 paragraf 2 të KPRK-së, i propozon gjykatës që të hiqet, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar të datës 15.07.2020, ka deklaruar në mënyrë vullnetare, duke ditur që më parë pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, se e pranon fajin për veprën penale e cila i vihen në barrë, ka shprehur keqardhje për veprimet e tija, jashtë penduar shumë, me të dëmtuarën i ka raportet e mira, kjo ka qenë hera e parë dhe do të jetë e fundit që ka kryer një veprim të tillë, tani bashkëshorten e ka edhe shtatzënë, ku presin një fëmijë dhe i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, ngase bashkëshorten e do shumë dhe mendojnë që të jetojnë së bashku gjithë jetën.

Prokurori i shtetit Enis Gashi, sa i përket pranimit të fajësisë të bërë nga i akuzuari, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, pasi që një pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, duke i ditur që më parë pasojat dhe favoret e pranimit të fajësisë, pasi që i njëjti pranim ka mbështetje në provat dhe shkresat që i janë bashkangjitur akuzës.



2020:042945

E dëmtuara E.G., sa i përket pranimit të fajësisë të bërë nga i akuzuari, ka deklaruar se nuk ka vërejtje, ia ka falur, janë pajtuar, jetojnë së bashku, presin një fëmijë, kjo ka qenë hera e parë që i njëjti ka ushtruar dhunë ndaj saj, mirëpo që nga ajo kohë nuk është përsëritur, i ka kuptuar gabimet e veta, është penduar, jetojnë në harmoni, kanë raporte të mira dhe si palë e dëmtuar nuk parashtron kurrfarë kërkese për kompensim dëmi.

Mbrojtësja e viktimave F.B-Q. sa i përket pranimit të fajësisë të bërë nga i akuzuari, ka deklaruar se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë të bërë nga i njëjti, si dhe e mbështet në tërësi deklarimin e të dëmtuarës.

Meqenëse i akuzuari e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, Gjykata ka vërtetuar se janë përmbushur kërkesat nga neni 248 paragraf 1, pika.1.1., 1.2 dhe 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, përkatësisht vlerësoj se i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se ky pranim i fajësisë është bërë në baza vullnetare dhe se ka mbështetje edhe në faktet dhe provat që përmban aktakuza. Po ashtu, ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe nuk ekziston asnjë nga rrethanat për hedhjen e aktakuzës apo të pushimit të procedurës penale të parapara me nenin 253 paragraf 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, andaj edhe ia ka pranuar këtë pranim të fajësisë për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 paragraf 1 të KPRK-së.

Gjykata ka analizuar dispozitat ligjore të veprës penale të sulmit, ku në nenin 184 paragraf 1 të KPRK-së, është parashikuar forma themelore e veprës penale dhe sipas kësaj dispozite këtë formë të veprës e penale e kryen " kushdo që me dashje përdor forcën ndaj personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Kështu që duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lart cituara, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, konsumohen të gjitha tiparet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, pasi është vërtetuar se i akuzuari ditën kritike i revoltuar e sulmon fizikisht të dëmtuarin, duke e goditur me grusht në krah, me çka të njëjtës i ka shkaktuar dhimbje, andaj për këtë gjykata ka vendosur që të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta gjykoi ne bazë të Ligjit, më parë duke ia vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69, 70, 71 paragraf 1 nën paragraf 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti pranimin e fajësisë. kërkim faljen e bërë ndaj të dëmtuarës edhe publikisht, e njëjta është shtatzënë, ku presin një fëmijë, pendimin për veprimet e tija, ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryen vepër tjetër penale, ngase bashkëshorten e do dhe mendojnë që të jetojnë së bashku gjithë jetën, jetojnë nga puna e të akuzuarit që punon në autolarje që realizon të ardhura në shumë prej 200 euro, paraqitjen për herë të parë para gjykatës, pasi që më parë i njëjti nuk ka qenë i dënuar. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese, gjykata në rastin konkret, pati parasysh se i njëjti veprën penale e ka kryer ndaj të dëmtuarës të cilën e ka bashkëshorte dhe kemi të bëjmë me vepër penale të dhunës në familje.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se shqiptimi i dënimit me burg për të akuzuarin në kohëzgjatje prej 90 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse brenda kohës së verifikimit



2020:042945

në afatin prej 1 (një) viti, nuk do të kryen i akuzuari vepër tjetër penale, nën mbikëqyrjen nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij, i paraparë në nenin 38 dhe 47 të KPRK-së, i cili konsiston me parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, si dhe ti tërhiqet vërejtja me kërcënimin e dënimit, për të ndaluar të mos kryej vepër penale.

Vendimin për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit me kusht është marrë konform nenit 55 të KPRK-së, duke urdhëruar që dënimin me kusht ta mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Shërbimi Sprovues i Kosovës Zyra Rajonale në Gjakovë, ngase konsideron se përmbushja e dënimit me kusht të shqiptuar nga gjykata, arrihet më së miri përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Gjykata të dëmtuarën nuk e ka udhëzuar në kontest civil, pasi që e njëjta nuk ka kërkuar kompensim dëmi.

Sa i përket vendimit mbi shpenzimet procedurale dhe paushallit gjyqësor u murr në bazë të nenit 450 dhe 453 të KPPK-së, ashtu që i akuzuari obligohet që të paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20.- €, ndërsa vendimi mbi pagimin e shumës prej 30 euro, u muarr konform nenit 39 paragraf 3 nën paragraf 3.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më latë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL**
**P.nr. 122/2020 të datës 15.07.2020**

**Zyrtarja ligjore** **Gjyqtarja vetme gjykuese**
**Shkendije Halilosmani** **Besarta Doli**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij Aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, duke u llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.



2020:042945